

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.97, DATË 4.3.2013, “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është disiplinimi dhe normimi me ligj i shërbimit të medias në tërësi dhe i shërbimeve të publikimeve elektronike në veçanti, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare, një fenomen që haset gjerësisht edhe në vendet e tjera. Mediat elektronike (*on-line*) janë një trend në rritje, të cilat po shmangin dhe po zëvendësojnë mediat tradicionale, për shkak edhe të lehtësisë së aksesit të çdo individi dhe përdorimit të portaleve *on-line* nga një numër i pakufizuar personash.

Shqetësimi për përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme në epokën digjitale dhe ndikimi negativ që ka dezinformimi tek besueshmëria dhe pavarësia e gazetarisë profesionale, tek vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut është, gjithashtu, një problematikë, e cila dikton nevojën për ndërhyrje legislative, me qëllimin parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative që passjell në shoqëri keqinformimi dhe përhapja e lajmeve të rreme nga portalet *on-line*, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm pasi lehtësojnë mundësinë e ndërveprimit social dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet individëve.

Prandaj, për të mbrojtur veçanërisht dinjitetin dhe reputacionin e individit, të miturit nga përmbajtjet e dëmshme dhe të gjithë qytetarët nga nxitja ndaj urrejtjes, dhunës etj., propozohet amendimi i ligjit për mediat audiovizive, duke përfshirë në kontekstin e këtij ligji edhe rregullimin e mediave elektronike.

Gjithashtu, vlen të theksohet që pavarësisht ndryshimeve të propozuara, ky projektligj në asnjë dispozitë të tij nuk cenon lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizuale dhe elektronike, por synon përcaktimin e disa

rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike, në mënyrë që të respektohen dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e diskursit publik.

II. VLERËSIM I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA

Projektligji nuk është përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, por është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare, për garantimin dhe mbrojtjen e dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji synon krijimin e një kornize ligjore për rregullimin dhe disiplinimin e përmbajtjes së informacionit të ofruar nga media, me qëllim garantimin e së drejtës së informimit, të lirisë së shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut, respektimin dhe garantimin e së drejtës së ruajtjes së jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve, moslejimin e transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën etj.

Teknologjia digjitale mund të shërbejë si një forcë shumë e fuqishme për të minuar proceset demokratike dhe lajmet e rreme shkatërrojnë cilësinë e diskutimit në demokraci dhe marrëdhëniet e qytetarëve me qeverinë, ndaj është i nevojshëm përcaktimi i disa rregullave ligjore dhe standardeve etike e profesionale, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

Zhvillimet digjitale kanë krijuar mundësitë për përfshirjen e llojeve të reja të shërbimeve dhe aktiviteteve që kanë ndikuar në mënyrat e ndërveprimit social dhe formësimin e individëve nëpërmjet përhapjes së informacionit me lehtësi dhe aksesit të pakufizuar.

Ndryshimet e shpejta që po ndodhin në shoqëri, si në fushën e teknologjisë, shkencës, ekonomisë dhe kështu me radhë, kanë ndikim edhe në krijimin e normave të reja ligjore që nuk janë parashikuar më parë. Në momentin e

miratimit të ligjit për mediat audiovizive në vitin 2013, roli i teknologjisë dhe internetit në përhapjen e informacionit nuk ishte në dimensionet që ka arritur sot informimi nëpërmjet portaleve *on-line*. Në këto kushte, duke mbajtur në fokus veçanërisht influencën e portaleve *on-line* gjatë viteve të fundit është e nevojshme që të ndërmerret kjo nismë me qëllim që zhvillimet teknologjike sociale etj., të ecin paralelisht me evoluimin e kuadrit ligjor.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera, si Gjermania, Mali i Zi, Letonia dhe Kroacia dhe është konstatuar se rregullimi i përmbajtjes së publikimeve elektronike është normuar me ligj edhe në këto shtete. Gjatë përgatitjes dhe hartimit të dispozitave konkrete të këtij projektligji është marrë si model veçanërisht ligji kroat “Për mediat elektronike”, i cili që në nenin 1 të tij parashikon se ky ligj rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë dhe fizikë, të cilët ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe shërbimet e publikimeve elektronike nga rrjetet e komunikimit elektronik, duke vijuar më pas rregullimin e veçantë të secilit shërbim në dispozita konkrete të ligjit.

Gjithashtu, vlen të përmendet se ligji kroat është përafruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për shërbimin mediatik me zë dhe figurë, versioni i kodifikuar), njësoj si ligji për mediat audiovizive në Shqipëri. Në këtë kontekst, duhet mbajtur parasysh se direktivat janë të detyrueshme për sa i përket objektivave të tyre, ndërkohë që mënyrat e zgjidhjeve mbeten në diskrecion të secilit shtet.

Ndjekja e modelit të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, siç është Kroacia, për hartimin e këtij projektligji, por duke e përshtatur me kontekstin shqiptar, është një argument tjetër bindës që vërteton se me miratimin e këtij projektligji Shqipëria është në të njëjtën linjë zhvillimi me vendet e tjera të BE-së dhe nuk është në shkelje të legjislacionit komunitar.

Për sa më sipër, vlerësohet se është i domosdoshëm miratimi i një kornize ligjore në mënyrë që të pasqyrojë zhvillimet në treg, për të arritur një ekuilibër ndërmjet qasjes në shërbimet e përmbajtjes *on-line*, mbrojtjen e konsumatorit

dhe konkurrencën si dhe arritjen e një gazetarie profesionale, të lirë dhe të pavarur, e cila nuk e deformon diskursin publik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe është në përputhje me parimet kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi, duke siguruar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe garantimin e lirisë së shprehjes.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTARE*

Ky projektligj synon përafrimin me legjislacionin komunitar, pasi ligji nr.97/2013, i ndryshuar, është përafruar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për shërbimin mediatik me zë dhe figurë, versioni i kodifikuar), numri CELEX: 32010L0013, “Fletore zyrtare” e BE-së, seria L 95, datë 15.4.2010, e cila është amenduar së fundmi, me argumentimin që nga momenti i miratimit të kësaj direktive, tregu i shërbimeve audiovizive të medias ka evoluar në mënyrë domethënëse dhe të shpejtë për shkak të konvergjencës së vazhdueshme të televizionit dhe shërbimeve të internetit dhe në këtë aspekt nevojiten disa amendime për të normuar efektet dhe influencën e mediave *on-line* dhe shërbimeve të internetit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 27 nene.

Në nenin 1 të projektligjit propozohet ndryshimi i titullit të ligjit nr.97/2013, me këtë përmbajtje: “Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”, për të arritur qëllimin e synuar nëpërmjet kësaj nisme.

Një propozim, i cili formalizon qëllimin kryesor të kësaj nisme, është edhe amendimi i nenit 2, të ligjit, (neni 2 i projektligjit) duke zgjeruar objektin dhe duke shtuar në fushën e zbatimit të tij edhe shërbimet e publikimeve elektronike.

Nëpërmjet nenit 4 të projektligjit shtohen disa përkufizime në nenin 3 të ligjit në fuqi, duke përfshirë “Ofruesin e shërbimeve të publikimeve elektronike” dhe duke përkufizuar termin “Publikimet elektronike”, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve gjatë zbatimit të ligjit në praktikë.

Në nenin 5 të projektligjit propozohet ndryshimi i titullit të nenit 4 në “Parimet themelore të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve mediatike” dhe po në këtë nen propozohet zëvendësimi i fjalës “... audioviziv ...” me fjalët “... medias elektronike ...”.

Në nenin 6 të projektligjit përcaktohet se dispozitat e tij nuk mund të interpretohen në mënyrë të tillë që të japin të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes.

Neni 7 i projektligjit ndryshon titullin e kreut II, të ligjit.

Në nenin 8 të projektligjit përcaktohet se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve mediatike dhe shërbimeve të tyre mbështetëse në territorin e Republikën e Shqipërisë.

Nenet 9 dhe 10 synojnë saktësimin e funksioneve të AMA-s, duke përfshirë shërbimet mediatike në tërësi.

Neni 11 ripërcakton kompetencat e Këshillit të Ankesave në raport me ndryshimet ligjore të synuara.

Në nenin 12 synohet që strategjia për mënyrën e realizimit të funksioneve të AMA-s të përfshijë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias, së bashku me përputhshmërinë e shërbimeve të medias me rregullat dhe detyrimet etike.

Në nenin 13 përfshihen në parashikimet e nenit 22 edhe publikimet elektronike.

Në nenin 14 zgjerohen kompetencat e AMA-s, në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e ligjit dhe mbajtjes dhe publikimit të Regjistrit të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike.

Neni 15 ndryshon nenin 30 të ligjit, duke përcaktuar rregulla për ofruesit e shërbimeve mediatike në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 16 saktëson llojet e ofruesve të shërbimeve mediatike, duke përfshirë në ofruesit e shërbimeve të medias së shkruar median e shtypur dhe publikimet elektronike.

Në nenin 18 të projektligjit shtohen nenet 33/1 dhe 33/2 në ligjin në fuqi, që përcaktojnë detyrimet e OSHPE-ve dhe identifikimin/regjistrimin e ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike.

Në nenin 19 të projektligjit shtohet neni 37/1 në ligjin në fuqi, që përcakton rregulla për Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike.

Në nenin 20 ndalohen të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingot televizive.

Në nenin 21 të projektligjit shtohet neni 51/1 në ligjin në fuqi, që përcakton procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave.

Në nenin 23 të projektligjit shtohet neni 53/1 në ligjin në fuqi që përcakton të drejtën e përgjigjes për OSHPE-të.

Neni 24 i projektligjit ndryshon nenin 132 të ligjit në fuqi lidhur me përcaktimin e masave për shkeljet që vendos AMA.

Neni 25 përcakton masat që vendosen nga KA-ja në rastin e shkeljeve ligjore të neneve 33/1, 51/1 dhe 53/1 nga OSHPE-të.

Neni 26 përcakton disa saktësime në masat e kundërvajtjeve administrative për shkeljet që kryhen nga OSHMA-ja dhe OSHPE-ja, si dhe shtimin e një sanksioni të ri administrativ në rastin kur nuk respektohet vendimi i KA-së.

Neni 27 përcakton hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Mediave Audiovizuale dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe ekspertë të fushës, dhe do të paraqitet pranë Këshillit të Ministrave, si bashkëpropozim i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE